




BASHKËPUNIMI



VLERË E DEMOKRACISË

DEMOKRACIA DHE PAQJA

REJAN (13), RON (14), ARDONIS (13), AGNESA (13), ALTIN (14)



Në Punëtorinë e Demokracisë „Demos-ti“ ne sot mësuam pikërisht për demokracinë dhe rëndësinë e saj

Ne si qytetarë të një shteti demokratik siç është Kosova, jetojmë në bazë të disa elementeve siç janë: paqja, toleranca, solidariteti, barazia dhe respekti.

Që nga shpallja e Pavarësisë së Kosovës (17 shkurt 2008) ne jetojmë të lirë dhe në demokraci. Andaj, ne duhet të jemi paqësorë dhe të solidarizohemi me të tjerët. Bie fjala, nëse e takojmë një person me aftësi të kufizuara i cili ka problem të depërtojë në trotualet e qytetit, ne duhet t'ia ofrojmë ndihmën tonë. Në këtë mënyrë jemi solidarizuar me të. Po ashtu, duhet të jemi tolerantë me njëri-tjetrin. Në rast se ne nuk pajtohemi me mendimin e dikujt tjetër, ne duhet të jemi tolerantë dhe ta respektojmë atë. Nuk duhet të harrojmë se ne kemi shumë të drejta demokratike. Ne si qytetarë kemi të drejtë të shkollohemi, të punësohemi, të votojmë, të argëtohemi, të kemi një identitet, të shprehemi lirishtëm etj. Njërit nga pjesëtarët e grupit tonë i ka rastisur ta takoj një person të racës dhe fesë tjetër, mirëpo mes tyre ka pasur tolerancë dhe respekt. Ky është një shembull shumë i mirë sesi të gjithë jemi të barabartë në demokraci. Demokracia i ka fillet e saja në Athinë, në kryeqytetin e Greqisë në vitin 507 para erës sonë. Demokracia në atë kohë ishte shumë më e mangët se kjo e sotmja. Kjo për shkak se, në votim merrnin pjesë vetëm burrat të cilët kishin toka shumë dhe kon-

sideroheshin të pasur. Fatkeqësisht pleqtë, gratë dhe personat me gjendje të dobët ekonomike nuk kishin të drejtë të votonin. Kurse sot, të gjithë jemi të barabartë para ligjit si dhe në mes vete. Demokracia ndahet në dy lloje kryesore: demokracinë e drejtpërdrejtë dhe demokracinë përfaqësuese. Demokracia e drejtpërdrejtë është kur populli mbledhet dhe zgjedh përfaqësuesit aty për aty. Ndërsa, demokracia përfaqësuese është kur populli me anë të votës i zgjedh përfaqësuesit. Mirëpo, edhe demokracia përfaqësuese ndahet në dy sisteme: sistemin presidencial dhe atë parlamentar. Sistemi parlamentar funksionon në vendin tonë, ku Parlamenti apo Kuvendi ka më shumë kompetenca se Presidenti. Në sistemin presidencial Presidenti ka më shumë kompetenca sesa Parlamenti, siç ndodh në SHBA. Ne kemi një porosi për të gjithë moshatarët tanë: konsideroni shokët/shoqet të barabartë dhe mos ofendoni askënd, por jeni tolerantë.



Autorët e artikullit

TË DREJTAT DHE PËRGJEGJËSITË TONA

BLEONA (14), YLLI (14), BLENARDI (13), LIRIDONI (14), RINORI (14)

Të drejtat tona janë pjesë e jetës sonë, por edhe përgjegjësitë janë të pranishme

Qytetar është çdo person i cili ka leje qëndrim në një shtet të caktuar. Qytetarë jemi edhe ne pasi që kemi të drejta dhe përgjegjësi. Ne duhet të jemi të përgjegjshëm sepse të qenurit të përgjegjshëm na bën qytetarë më të mirë dhe më aktiv. Për shembull, ne si nxënës jemi të vetëdijshëm për rregullat e shkollës tonë siç janë: respekti ndaj mësimeve dhe ndaj njëritjetrit, të mos vrapojmë në korridoret e shkollës etj. Gjithashtu, këtu në Punëtorinë e Demokracisë „Demos-ti“ kemi bërë një marrëveshje që të kemi respekt ndaj njëritjetrit, të mos ia ndërpresim fjalën njëritjetrit etj. Të drejtat gjithashtu janë pjesë e jetës sonë. Disa nga të drejtat janë: çdo njeri ka të drejtë të jetë i barabartë me të tjerët pa dallim feje, race apo gjinie. Çdo njeri ka të drejtë të shkollohet, ku shkollimi fillor

është i obligueshëm. Gjithashtu, ne qytetarët e Kosovës kemi edhe të drejtën e punësimit, e shumë shumë të drejta të tjera.


Ne kemi një mesazh për bashkëqytetarët tanë që nëse ata dëshirojnë të jenë më të shëndetshëm, duhet që ta ruajnë dhe të kujdesen për mjedisin.



Të gjithë jemi të barabartë pa asnjë dallim



Qytetarë të Kosovës



Ne lindim me të drejtën për të votuar



Ne kemi përgjegjësi ta mbajmë ambientin pastër



Ne kemi përgjegjësi ta ndihmojmë njëritjetrit

PËR DEMOKRACINË

EDISON (14), ERVIN (13), DIAMANT (14), RIAD (14), RONA (13), ANDI (13)



Demokracia na mundëson...

Demokracia na jep të drejta të plota, të cilat janë të barabarta pavarësisht racës, fesë, gjinisë, etnicitetit etj. Mirëpo, në këtë formë të qeverisjes ekzistojnë ligje të cilat duhet të zbatohen.

Për të funksionuar një vend sa më mirë, duhet të respektojmë ligjet të cilat miratohen nga Pushteti Legjislativ, Kuvendi. Kuvendi i Kosovës përbëhet prej 120 deputetëve. Prej tyre 100 vende janë të garantuara për deputetë të kombit shqiptar, kurse 20 vende për deputetët e komuniteteve jo shumicë. Përveç funksionit legjislativ, ai ka edhe dy funksione të tjera, të cilat janë funksioni kontrollues dhe ai përfaqësues.

Qeveria (Pushteti Ekzekutiv) kontrollohet nga Kuvendi. Qeveria përbëhet prej: Kryeministrit, zv. kryeministrave dhe prej ministrave. Disa prej ministrave janë: Ministria e Arsimit, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Infrastrukturës etj.

Komisionet parlamentare janë grupe punuese që përbëhen prej deputetëve, të cilët bëjnë shqyrtimin e projektligjeve. Për shembull, nëse Ministria e Arsimit e propozon një ligj, atëherë ai ligj shkon tek Komisioni për Arsimit.

Pushteti Gjyqësor u takon gjykatave të cilat merren me vendosjen e drejtësisë. Gjykatat ndahen në tri lloje: Gjykata Themelore, Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme.

Gjykata Themelore ka në çdo komunë të Kosovës, por

Gjykata Supreme dhe Gjykata e Apelit janë vetëm në kryeqytet. Gjykata Supreme është gjykata e cila merret me krimet më të rënda.

Pushteti edhe pse ndahet në tri degë dhe secila prej tyre punon në mënyrë të pavarur, ato janë të lidhura me njëra-tjetrën dhe kanë për qëllim mirëqenien e popullit.

Zëri ynë duhet të dëgjohet, dhe demokracia na mundëson këtë.



Gazetarët e këtij artikulli



Të gjithë e kemi të drejtën e shkollimit



Paqja arrihet me tolerancë dhe mirëkuptim



Ne bashkëpunojmë me njëri-tjetrin



Vizita jonë në Kuvendin e Republikës së Kosovës



Shkolla jonë, vendi ku mësojmë shumë gjëra



E drejta e votës, e drejtë shumë e rëndësishme



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Emin Duraku“
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: VIII-1
Website: www.demos-ti.org Vendi: Prishtinë